



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:092422
Datë: 10.05.2024
Numri i dokumentit: 05670857

Pml.nr.252/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Valdete Daka, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. R., nga P., për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.285/2023, të datës 10.11.2023 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.748/2023, të datës 16.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit S. R., e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.285/2023, të datës 10.11.2023 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.748/2023, të datës 16.02.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.285/2023, të datës 10.11.2023, i dënuari S. R., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është

shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vjetëve dhe dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë të papaguar, do të llogaritet me një (1) ditë të dënimit me burgim.

Duke u bazuar në nenin 366 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të dënuarit S. R., i është vazhduar paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa konform nenit 79 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar me burgim, të dënuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.04.2023 derisa i njëjti të gjendet në paraburgim.

Duke u bazuar në nenin 267 të KPRK-së, është konfiskuar substanca narkotike e llojit "Marihuanë" që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme prej 4903.19 gram dhe dy (2) peshore, ndërsa është urdhëruar Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, që të merr në administrim sendet e konfiskuara në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (Ligji Nr. 05/I-049), pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është detyruar i dënuari S. R., që të emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind (100) euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.748/2023, të datës 16.02.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe të mbrojtëses së të dënuarit S. R., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësja e të dënuarit S. R., avokatja Sahadete Gashi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6 dhe 8 të KPP-së dhe shkeljeve të ligjit penal, nga neni 385 të KPP-së, duke propozuar që aktgjykimet e lartcekura të gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen, duke e rikualifikuar veprën penale për të cilën është shpallur fajtor në veprën penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", nga neni 269 i KPRK-së apo që këto aktgjykime të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.141/2024, e datës 25.04.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses të të dënuarit S. R., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësja e të dënuarit S. R., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyetimin, kurse në arsyetimin e aktgjykimit në fjalë nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare, kurse ato që janë paraqitur janë të paqarta, kundërthënëse dhe jo të sakta.

Edhe sa i përket vlerësimit të rrethanave rënduese, mbrojtësja e të dënuarit pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është hartuar në pajtim me nenin 369, paragrafët 6 dhe 8 të KPP-së, pasi që me rastin e matjes së dënimeve, gjykata në fjalë ka gjetur si rrethanë rënduese sjelljen e mëhershme të të dënuarit, përkatësisht të kaluarën e tij, mirëpo në arsyetim të aktgjykimit nuk është theksuar se me cilat vendime i njëjti është shpallur fajtor, nuk janë specifikuar me numër këto aktgjykime, mandej nuk është përcaktuar se për çfarë veprë penale është shpallur fajtor dhe nëse aktgjykimi është bërë i formës së prerë.

Gjithashtu, pretendohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit i ka mbivlerësuar rrethanat rënduese në raport me ato lehtësuese, me ç'rast edhe si rezultat kësaj, ndaj të dënuarit S. R. janë shqiptuar dënime shumë të rënda, pasi që i dënuari qysh në fazat e hershme ka shprehur pendim të thellë, ka kërkuar falje për atë çfarë i ka ndodhur, qysh në fillim ka pranuar veprimet e tij, por jo edhe cilësimin juridik të veprës penale, gjë që tregon se i njëjti është penduar dhe në të ardhmen do të silllet mirë dhe nuk do të kryejë vepra penale.

Në lidhje me dënimin e shqiptuar, mbrojtësja e të dënuarit, gjithashtu pretendon se ndaj të dënuarit S. R., janë shqiptuar dënime të rënda, pasi që për raste të njëjta, gjykatat tjera kanë shqiptuar dënime më të buta.

Nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, shihet që mbrojtësja e të dënuarit nuk e ka përcaktuar konkretisht se në çfarë konteksti dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyetimin dhe gjithashtu, nuk është përcaktuar konkretisht ku qëndrojnë kundërthëniet dhe të metat e arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç nuk janë të përfshira as me ndonjë shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit S. R.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur ndonjë paqartësi apo kundërthënie, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del të jetë në harmoni të plotë edhe me arsyetimin, ndërsa në arsyetim të aktgjykim rezultojnë se janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha çështjet e rëndësishme, duke përfshirë këtu, edhe aspektin subjektiv të veprës penale, përkatësisht dashjen dhe qëllimin e të dënuarit për ta shitur dhe shpërndarë substancën narkotike, kurse arsyet e paraqitura gjejnë mbështetje edhe në provat, në veçanti në provat materiale që janë administruar gjatë të shqyrtimit gjyqësor.

Edhe sa i përket pjesës së dënimeve të shqiptuara ndaj të dënuarit S. R., arsyetimet e aktgjykimeve të instancave më të ulëta, rezultojnë të jenë të mjaftueshme dhe të qarta, pasi që në to janë paraqitur dhe përshkruar rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rënduese të cilat ishin marrë parasysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimeve. Në këtë drejtim, rezultojnë se janë vlerësuar dhe marrë për bazë rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rënduese që i referohen si veprës penale, ashtu edhe cilësive dhe sjelljeve të të dënuarit, duke e pasur parasysh edhe faktin se i dënuari S. R., edhe më parë kishte qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprave tjera penale.

Kështu, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se i dënuari S. R., ka qenë i dënuar edhe më parë me aktgjykimin PKR.nr.732/2014, i cili aktgjykim është bërë i formës së prerë më datën 29.04.2022, për shkak të veprës penale të natyrës së njëjtë, përkatësisht për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, andaj, edhe në këtë drejtim, pretendimet e mbrojtjes nuk qëndrojnë.

Edhe pretendimi i mbrojtjes në lidhje me krahasimin e dënimeve të shqiptuara ndaj të dënuarit S. R., me raste tjera të ngjashme është konsideruar si i pabazuar, pasi që Gjykata Supreme e Kosovës thekson se secila çështje penale përmban specifikat e përkatëse, mbi bazën e së cilave mandej duhet nxjerrë konkluzione të caktuara, që mund t’i referohen si dënimeve të shqiptuara, ashtu edhe çështjeve tjera.

Në anën tjetër, sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimeve dhe vlerësimit të rrethanave përkatëse lehtësuese dhe rënduese, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkalimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, konsiderohet si shkelje e ligjit penal. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykatat e instancave më të ulëta duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit S. R., i kanë shqiptuar dënime me burgim dhe me gjobë, brenda kufijve të parashikuar me ligj për veprën penale për të cilën i njëjti edhe është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkalluar kompetencat ligjore.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës edhe në këtë çështje penale rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin

e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Duke qenë se në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk janë paraqitur konkretisht se ku qëndrojnë shkeljet e ligjit penal dhe cilat dispozita të ligjit penal janë shkelur, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur ndonjë shkelje të kësaj natyre, kurse në anën tjetër, nga përshkrimi faktik i veprimeve kryerëse të paraqitura në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se në veprimet e të dënuarit S. R., qëndrojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së dhe nuk bëhet fjalë për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, nga neni 269 i KPRK-së, aspekte këto që janë arsyetuar mjaftueshëm edhe nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.252/2024, më datë 07.05.2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi